



■ Nëse fëmija juaj organizon një festë apo një zhurkë, mbështetni atë me rregulla të qarta!

- Ndhmoni fëmijën tuaj në sajimin e ftesave me shkrim (vendi, koha, kohëzgjatja, lista e të ftuarve, numri i telefonit).
- Merrni përsipër përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen e nevojshme.
- Ndalojeni ofrimin e alkoolit (gjithashtu edhe alkopops! [pije alkooli e miksuar]).
- Thuani qartë se duhani është i padëshiruar dhe drogat janë të ndaluara.
- Mos lejoni zhurka në shtëpinë tuaj pa marrëveshje me ju, në qoftë se nuk jeni vet prezent.
- Kërkoni nga fëmijët tuaj që të merren vesh me fqinjët (zhurma).
- Organizojeni që më parë rregullimin e ambienteve pas zhurkës.
- Mos lejoni zhurka gjatë ditëve të punës dhe të shkollës, po qe se zgjasin më tepër se deri në orën 20 gjegjisht 22.

Rekomandime për kohërat e kthimit

Mosha e fëmijës	7 deri 10 vjeç	deri 14 vjeç	deri 16 vjeç
Të dielën deri të enjtën gjatë kohës së shkollës	Ora 18	Ora 20	Ora 22
Të premten/të shtunën dhe gjatë pushimeve të shkollës	Ora 19/20	Ora 22	Ora 24

Rekomandohet që në muajt e dimrit, kohërat e përmendura më sipër, të vendosen një orë më përpara. Fëmijët më të vegjël duhet të kthehen në shtëpi me rënien e errësirës.

■ Fëmija juaj do të duhej të dijë se si të përgjigjet ndaj pyetjeve në vijim ...

... nëse del jashtë në mbrëmje

- Ku shkon?
- Me kë?
- Si, me çka?
- Kur do kthehesh në shtëpi?

... nëse viziton një zhurkë apo një rast tjetër

- Kush e organizon?
- Ku ndodh organizimi?
- Për kë është parashikuar rasti? (grupmosha)
- Cili person i rritur e mban përgjegjësinë? (numri i telefonit)
- Sa do të zgjasë rasti? (caktim i kohës për t'u kthyer në shtëpi)
- Si është i organizuar kthimi në shtëpi?

■ Gjumi

Keni parasysh, se fëmijet deri në moshën 10 vjeçare kanë nevojë për mesatarisht 10 orë gjumë, të rinjtë nga afro 14 vjeç, 8 orë.

■ Qasja ndaj alkoolit dhe drogave

- Flisni si prindër me vajzën tuaj / me djalin tuaj për konsumimin e alkoolit dhe të lëndëve narkotike.
- Parimisht ndalohet ofrimi i alkoolit ndaj të rinjve nën 16 vjeç.
- Forconi vetëdijën e fëmijës suaj, duke i thënë se mospirja e duhanit është «cool» dhe lirë.

DORACAK PËR PRINDËRIT

Botuesi

Grupi punues i prindërve
Drejtoria e shkollës



Doracakun për prindërit mund ta gjeni edhe në internet
www.brigga.ch





■ Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve të tyre?

Në artikullin 296 të kodit civil të Zvicrës (ZGB) gjindet e fiksuar pika, që fëmijët, të cilët janë në moshë të mitur (pra pa i mbushur 18 vjet), i nënshtrohen kujdesit prindëror. Kujdesi prindëror e përfshin detyrimin ligjor dhe të drejtën ligjore, për t'i marrë të gjitha vendimet e nevojshme për fëmijët e mitur, për të edukuar dhe përfaqësuar fëmijët, për të administruar financat dhe për të caktuar vendqëndrimin.

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve në edukim janë të fiksuar, ndër të tjera, në këtë mënyrë: Prindërit, duke pasur parasysh të mirën e fëmijës, e mbikëqyrin kujdesin dhe e drejtojnë edukimin e fëmijës së tyre, duke i marrë të gjitha vendimet e nevojshme, por me rezervën e respektimit të aftësisë vepruese personale të fëmijës. Fëmija i ka borxh prindërve dëgjueshmërinë; prindërit i lejojnë fëmijës së tyre lirinë për shtjellimin e jetës së tyre, por duke pasur parasysh pjekurinë që kanë, dhe në çështjet e rëndësishme, me sa është e mundur, i marrin parasysh mendimet e fëmijëve (Neni 302 ZGB alinea 1 dhe 2).

Në këtë qasje, të dashur prindër, ju falenderojmë, nëse e perceptoni përgjegjësinë që keni ndaj fëmijëve tuaj, duke i trajtuar me përgjegjësi të drejtat dhe detyrimet, në të mirë të familjes dhe të bashkësisë suaj.

■ Paratë e xhepit

Udhëzime

Paratë e xhepit kuptohen si një pagesë vullnetare, duke u konsideruar nga shumica e prindërve si një gjë e favorizuar. Lartësia e parave të xhepit i nënshtrohet mundësive dhe shprehive të prindërve. Prindërit dhe fëmijët vendosin së bashku, se për çfarë do të shfrytëzohen paratë e xhepit.

Rregullat

- Pagesa të bëhet në mënyrë të rregullt dhe pa u urdhëruar
- Caktimi i qartë, se për çfarë duhet të mjaftojnë
- Të mos kërkohet llogari për secilin shpenzim
- Të mos keqpërdoret si mjet presioni apo edukimi
- Të mos zihen boshllëqet dhe të mos jepen kredira

Rekomandim Paratë e xhepit

Mosha e fëmijës	Franga në javë
1. Viti i parë	1.00 deri 1.50
2. Viti i parë	1.50 deri 2.00
3. Viti i parë	2.00 deri 2.50
4. Viti i parë	2.50 deri 3.00
Mosha e fëmijës	Franga në muaj
Viti i 5./6. Shkollor	15.00 deri 25.00
Viti i 7./8. Shkollor	25.00 deri 35.00
Viti i 9./10. Shkollor	35.00 deri 50.00

Rekomandimi i bashkësisë punuese i këshillëtoveve zvicrane (ASB)

Kontakt

Keni pyetje?

Keni nevojë për informata shtesë?

Qendra për zhvillim dhe terapi të fëmijëve dhe adoleshentëve (ZET)

☎ 027 922 38 65

**Zyra e punëve për të rinjtë
BRIGLINA**

☎ 027 924 40 74

Lidhja e Walisit kundër rreziqeve të varësisë (LVT)

☎ 027 923 25 72

Këshillime rreth profesionit

☎ 027 922 48 80

Policia e qytetit Brig-Glis

☎ 027 922 41 60

Drejtoria e shkollës Brig-Glis

☎ 027 922 42 30